



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:032097

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06378978

P.nr.69/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, me gjyqtaren Dardane Ismaili, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.S., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 e lidhur e par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, nr. PP.II.nr.37/23 të datës 06.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar jopublik, me datë 10.10.2024 në mungesë të të gjitha palëve në procedurë, me datë 10.10.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S... S... nga i ati A..., e ëma A..., e gjinisë A..., i lindur me datë ... në Mitrovicë, tani me vendbanim në "..."- Mitrovicë, me numër personal ..., i martuar, punon në ndërtimtari, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 30.12.2022 rreth orës 18:45 minuta në sheshin ... në Mitrovicë, konkretisht në banesën e tij i pandehuri me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore tani të dëmtuarës bashkëshortes së tij, ashtu që i pandehuri me të dëmtuarën fillimisht kishin një mosmarrëveshje verbale e më pas e godet me shuplaka në fytyrë dhe grushte në krahë dhe shpinë që si pasojë e goditjes e

dëmtuara pëson lëndime të lehta trupore të cilat lëndime janë konstatuar nga ekspertiza mjekoligjore si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 e lidhur e par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40,42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 lidhur me nenin 185 par.3 pika 3.1 e lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe neneve 364, 365, 449, 452 dhe 462 të KPP-së të pandehurit S. S. i:

SH Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR, në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. OBLIGOHET, i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20), euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Pala e dëmtuar A. A. – S. për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.37/23 të datës 06.02.2023, kundër të pandehurit S. S. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 e lidhur e par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 10.10.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri S.S., e dëmtuara A. A.-S.si dhe mbrojtësi i viktimave Muhamet Përvetica.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. Gjithashtu deklaroi se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, që është penduar dhe premtonte se në të ardhmen nuk do ta përsërisë kryerjen e veprës penale, i njëjti deklaroi se me të dëmtuarën nuk kanë pasur më mosmarrëveshje që nga dita kritike.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intesitetin e rrezikimit apo vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilën është kryer vepra penale, faktin që vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe që kemi të bëjmë me viktimitë të ndjeshme.

E dëmtuara në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ndërsa lidhur me sanksionin penal ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit të i'a shqiptoj një dënim sa më të butë duke shtuar se me të njëjtin janë pajtuar, presin një fëmijë dhe nuk kanë pasur probleme më mes vete.

Mbrojtësi i viktimave Muhamet Përvetica në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe i propozon gjykatës që të pandehurin mbi bazën e rrethanave rënduese dhe lehtësuese ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Shton se kërkesën pasurore juridike në emër të viktimës e paraqesim të paspecifikuar duke i lënë gjykatës në vlerësim gjykimin e shumave që i konsideron të drejta.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor i datës:30.12.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarës A. S. i datës:30.12.2022, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit S.S. i datës 30.12.2022, raportet mjekësore për të dëmtuarën, ekspertiza mjekoligjore e datës 28.01.2023 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 e lidhur e par. 1 pika 1.4 të KPRK-së për të cilën veprën penale parashihet dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tri vjet për veprën penale nga par.1 i këtij neni ndërsa pika 1.4 dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana rënduese lidhur më këtë rast, gjykata vlerëson rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, si dhe duke marrë parasysh keqardhjen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore, gjithashtu rrethanë tjetër lehtësuese gjykata mori rrethanat e tij personale, se i njëjti është person familjar, i gjendjes së dobët ekonomike dhe se me palën e dëmtuar janë pajtuar dhe të njëjtit janë duke e pritur një fëmijë, si dhe premtimin gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Po ashtu, Gjkata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjkata ka vendosur që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko civil, duke u bazuar në nenin 462 të KPP-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 242, 365, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.69/2023, datë 14.10.2024

Gjyqtarja
Dardane Ismaili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.